

VENDIM
Nr. 479, datë 26.6.2026

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RIKONSTRUKSIONIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT NË BASHKITË
KURBIN DHE LEZHË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 327 350 000 (treqind e njëzet e shtatë milionë e treqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit në bashkitë Kurbin dhe Lezhë, të ndarë, si më poshtë vijon:

a) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi, në masën 30 100 000 (tridhjetë milionë e njëqind mijë) lekë pa TVSH;

b) Bashkisë Lezhë i transferohet fondi, në masën 297 250 000 (dyqind e nëntëdhjetë e shtatë milionë e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

2. Efekti financiar përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2026, dhe i transferohet bashkive Kurbin dhe Lezhë në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë si pasojë e fatkeqësisë natyrore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe bashkitë Kurbin dhe Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Albana Koçiu